

Fletore Zyrtare nr. 223

Data e publikimit në Fletore Zyrtare: 02/12/2025

VENDIM

Nr. 712, datë 26.11.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN
E KOMISIONIT TË REKRUTIMIT DHE ECURISË NË KARRIERË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Rekrutimit dhe Ecurisë në Karrierë, me qëllim menaxhimin e proceseve të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të inspektorëve, në përputhje me parimet e transparencës, meritës dhe ngritjes së vazhdueshme profesionale.

2. Në zbatim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Inspektor”, nëpunësi që ushtron funksione inspektimi në inspektoratet qendrore, strukturat e tjera inspektuese ose në Inspektoratin e Përgjithshëm, në pozicionet “inspektor”, “përgjegjës sektori”, “drejtor drejtorie” ose “kryeinspektor”;

b) “Kandidat”, çdo person jashtë strukturës inspektuese ose inspektori brenda strukturës inspektuese, i cili aplikon për një pozicion të lirë pune dhe përmbush kriteret e përgjithshme e të veçanta të përcaktuara në shpalljen përkatëse;

c) “Komisioni i Rekrutimit dhe Ecurisë në Karrierë” (në vijim, KREK), organi përgjegjës për organizimin e procedurave të rekrutimit, të ecurisë në karrierë dhe të vlerësimit fillestar e periodik të inspektorëve, në përputhje me parimet e transparencës, të meritës dhe objektivitetit;

ç) “Metoda STAR”, një teknikë e intervistës së strukturuar, që përdoret për vlerësimin e sjelljes së kandidatëve, përmes përshkrimit të një situatë konkrete sipas katër elementeve: situata, detyra, veprimi dhe rezultati;

d) “Strukturat e tjera inspektuese”, struktura që kryejnë funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe që janë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, por nuk janë të organizuara si inspektorate qendrore;

dh) “Trajnimi i detyrueshëm”, programi i zhvillimit të thelluar profesional, që zhvillohet pas emërimit të inspektorit, për sigurimin e standardeve të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksioneve të inspektimit;

e) “Vend vakant”, çdo pozicion pune i lirë, i shpallur për rekrutim, lëvizje paralele ose ngritje në detyrë, sipas strukturës e organikës së miratuar.

KREU II

**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË REKRUTIMIT DHE ECURISË
NË KARRIERË**

1. KREK-u organizohet si një strukturë *ad hoc* dhe ngrihet për organizimin e procedurave të rekrutimit e të ecurisë në karrierë të inspektorëve, në përputhje me kriteret dhe rregullat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Caktimi i anëtarëve të KREK-ut bëhet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm.

KREK-u ngrihet me urdhër të inspektorit të Përgjithshëm dhe ka në përbërje 3 (tre) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Zëvendësinpektorin e Përgjithshëm ose një përfaqësues në pozicionin drejtor në strukturën e Inspektoratit të Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit;

b) Një përfaqësues nga struktura përgjegjëse për ecurinë në karrierë të inspektorëve pranë Inspektoratit të Përgjithshëm;

c) Kryeinspektorin e Inspektoratit Qendror/drejtuesin e strukturës tjetër inspektuese, që ka shpallur vendin vakant ose një përfaqësues të autorizuar prej tij.

3. KREK-u, për pozicionin “drejtuesi i strukturës tjetër inspektuese”, ka në përbërje anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij kreu, dhe 1 (një) anëtar, titullarin e institucionit përkatës ose një përfaqësues të autorizuar prej tij.

4. KREK-u, për pozicionin “kryeinspektor i Inspektoratit Qendror”, ka në përbërje anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij kreu, dhe 1 (një) anëtar, përfaqësues i ministrit përgjegjës të Inspektoratit Qendror, në pozicionin “sekretar i përgjithshëm” ose “drejtor i përgjithshëm” në ministrinë përgjegjëse.

5. Gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të kandidatëve për pozicionet me funksione inspektimi, KREK-u mund të ftojë akademikë nga universitetet publike për të ofruar mbështetje profesionale në fushën përkatëse të veprimtarisë së Inspektoratit Qendror ose të Inspektoratit të Përgjithshëm, që ka shpallur vendin vakant, për hartimin e pyetjeve të testimit, si dhe gjatë procesit të intervistës së strukturuar me gojë të kandidatëve.

6. Anëtarët e KREK-ut, pasi janë njohur me listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar të përgatitur nga njësia përgjegjëse pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, plotësojnë formularin e vetëdeklarimit, që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Anëtarët e KREK-ut, sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij kreu, duhet të kenë të paktën 3 (tri) vjet përvojë pune në Inspektoratin Qendror/ish-inspektorat shtetëror ose në Inspektoratin e Përgjithshëm/ish-Inspektoratin Qendror dhe nuk duhet të kenë lidhje familjare apo konflikt interesi me kandidatët.

8. Anëtarët e KREK-ut duhet të tërhiqen nga një procedurë konkurrimi, në rastet kur ekziston një nga parashikimet e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Me njoftimin e heqjes dorë ose me konstatimin nga KREK-u, që anëtari është në kushtet e pengesës ligjore, inspektori i Përgjithshëm vendos zëvendësimin e anëtarit ose kërkon caktimin e përfaqësuesit nga Inspektorati Qendror, struktura tjetër inspektuese ose ministria përgjegjëse, që do të zëvendësojë anëtarin e tërhequr nga KREK-u. Inspektorati qendror, struktura tjetër inspektuese ose ministria përgjegjëse caktojnë përfaqësuesin, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, dhe njoftojnë menjëherë inspektorin e Përgjithshëm.

9. Në rastin e procedurave të rekrutimit ose të ecurisë në karrierë për plotësimin e vendeve vakante në Inspektoratin e Përgjithshëm, KREK-u përbëhet nga këta anëtarë:

a) Zëvendësinpektori i Përgjithshëm ose një përfaqësues në pozicionin “drejtor” në strukturën e Inspektoratit të Përgjithshëm;

b) Një përfaqësues në pozicionin “drejtor” në Inspektoratin e Përgjithshëm;

c) Një përfaqësues nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

10. Mbledhjet thirren nga kryetari i KREK-ut dhe janë të vlefshme kur marrin pjesë të gjithë anëtarët.

11. Secili anëtar ka të drejtën e një vote dhe abstenimi nga votimi nuk lejohet për asnjë anëtar të KREK-ut.

12. Vendimet e KREK-ut merren me shumicë votash dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Ato pasqyrohen në procesverbalin që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

13. KREK-u ka për detyrë:

- a) të përzgjedhë pyetjet për testimin me shkrim;
- b) të verifikojë dokumentacionin e paraqitur;
- c) të përcaktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e testimit me shkrim;
- ç) të realizojë intervistën e strukturuar me gojë;
- d) të kryejë vlerësimin;
- dh) të hartojë listën përfundimtare të renditjes të kandidatëve;
- e) të njoftojë me shkrim, sipas rastit, autoritetin që ka shpallur vendin vakant, ministrin përgjegjës, inspektorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin e Inspektoratit Qendror ose titullarin e strukturës me funksione inspektimi për kandidatin fitues së bashku me dokumentacionin përkatës, me qëllim emërimin dhe njoftimin zyrtar të tij;
- ë) të sigurojë trajtim të barabartë dhe objektiv për të gjithë kandidatët, në përputhje me parimet e barazisë, të meritës e të transparencës.

KREU III VLERËSIMI I KANDIDATËVE PËR EMËRIM NGA JASHTË SISTEMIT TË INSPEKTIMIT

1. Për emërim nga jashtë sistemit të inspektimit, vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas pikëve të ndara, si më poshtë:

- a) 60 (gjashtëdhjetë) pikë për testimin me shkrim;
- b) 30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c) 10 (dhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit, që konsiston në vlerësimin e përvojës, trajnimeve dhe certifikimeve të lidhura me fushën e inspektimit.

2. Vlerësimi i testimit me shkrim realizohet nëpërmjet pyetjeve me alternativa, pyetjeve të hapura ose rasteve studimore, sipas fushave të shpallura. Secili vlerësues e vlerëson individualisht testin dhe pikët mesatare llogariten me formulë (shuma e pikëve/numri i vlerësuesve).

3. Intervista e strukturuar me gojë vlerësohet mbi një seri pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët, që mund të përfshijnë:

- a) pyetje për sjelljen sipas metodës STAR;
- b) pyetje hipotetike për situata konkrete;
- c) pyetje për njohuritë dhe kompetencat teknike.

4. Vlerësimi i dokumentacionit përfshin përvojën, trajnime dhe certifikime, të lidhura me fushën e inspektimit, që vlerësohen sipas shkallës së tejkallimit të kërkesave të shpalljes, si dhe analizën e përvojës së mëparshme të punës, nivelit arsimor, trajnimeve dhe certifikimeve të kryera nga kandidati, të cilat lidhen me kriteret për pozicionin e shpalljes.

5. KREK-u përfundon procesin e vlerësimit të kandidatëve brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të procedurave të testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

6. Kandidati fitues për pozicionin përkatës shpallet kandidati, që ka më shumë pikë ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 (shtatëdhjetë) pikë.

7. Testimi me shkrim vlerëson njohuritë për legjislacionin për inspektimin, rregullat e etikës, procedurat administrative dhe fushën përkatëse të inspektimit.

8. Intervista e strukturuar me gojë vlerëson aftësitë logjike, komunikimin dhe përshtatshmërinë me pozicionin.

9. Inspektorati qendror përkatës apo struktura tjetër inspektuese njoftohet për kandidatin fitues për pozicionin e lirë të punës brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës përfundimtare të fituesve.

KREU IV VLERËSIMI I KANDIDATËVE PËR LËVIZJE PARALELE

1. KREK-u vlerëson vetëm aplikimet e kandidatëve, që përmbushin kriteret për lëvizje paralele, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, shkarkimin dhe lirin nga detyra të kryeinspektorit, inspektorit të Inspektoratit Qendror dhe të Inspektoratit të Përgjithshëm.

2. KREK-u nuk zhvillon testim me shkrim për këtë procedurë.

3. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet sipas këtij sistemi pikësh:

a) deri në 20 (njëzet) pikë për përvojën shtesë (10 për 1 vit, 15 për 1–3 vjet, 20 për më shumë se 3 vjet);

b) deri në 10 (dhjetë) pikë për trajnime të lidhura me fushën (3 për 1 trajnim, 5 për 2–3 trajnime, 10 për më shumë se 3 trajnime);

c) deri në 10 (dhjetë) pikë për vlerësimin e rezultateve në punë (3 për “mirë”, 5 për “shumë mirë”, 10 për “shkëlqyeshëm”).

4. Vlerësimi i kandidatëve për lëvizje paralele bazohet në intervistën e strukturuar me gojë dhe në dokumentacionin e paraqitur, që përfshin këto elemente:

a) përputhshmërinë e përvojës me kërkesat e pozicionit të shpallur;

b) rezultatin e vlerësimit të fundit në punë;

c) përfitimin e trajnimeve përkatëse.

5. Totali i vlerësimit është 100 (njëqind) pikë të ndara, si më poshtë:

a) 60 (gjashtëdhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë;

b) 40 (dyzet) pikë për vlerësimin e dokumentacionit, që konsiston në vlerësimin e përvojës, të trajnimeve të lidhura me fushën dhe vlerësimin e rezultateve në punë.

6. Pikët mbledhen e pjesëtohen me 3 (tre).

7. Kandidati fitues për pozicionin përkatës shpallet kandidati, që ka më shumë pikë ndër kandidatët, të cilët kanë marrë të paktën 70 (shtatëdhjetë) pikë.

KREU V VLERËSIMI I KANDIDATËVE PËR NGRITJE NË DETYRË

1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve për ngritje në detyrë realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, si më poshtë vijon:

a) testimi me shkrim, deri në 40 (dyzet) pikë;

b) intervista e strukturuar me gojë, deri në 40 (dyzet) pikë;

c) vlerësimi i dokumentacionit, që konsiston në vlerësimin e përvojës, të trajnimeve të lidhura me fushën e inspektimit dhe vlerësimin e rezultateve në punë deri në 20 (njëzet) pikë.

2. KREK-u përfundon vlerësimin e dokumentacionit brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga administrimi i listës së kandidatëve të kualifikuar.

3. Kandidati fitues për pozicionin përkatës shpallet kandidati, që ka më shumë pikë ndër kandidatët, të cilët kanë marrë të paktën 70 (shtatëdhjetë) pikë.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për institucionet/strukturat me funksione inspektimi, për të cilat nuk janë parashikuar ndryshime në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nuk zbatohen parashikimet e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, ministritë përgjegjëse, inspektoratet qendrore dhe strukturat e tjera inspektuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama